

VENDIM
Nr. 892, datë 24.12.2012

**PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË SPITALIT USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR
NË “SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS” DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
ADMINISTRIMIT TË TIJ NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E
SHËNDETËSISË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e emërimit të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar në “Spitali Universitar i Traumës” dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të tij nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë.

2. Spitali Universitar i Traumës është person juridik, publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili do të shërbejë si qendër kombëtare e traumës me funksion mjekësor, pedagogjik dhe kërkimor-shkencor.

3. Funksionet mjekësore, mësimore dhe kërkimore-shkencore të spitalit realizohen nga strukturat përkatëse në nivel shërbimi.

4. Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

5. Struktura dhe organika e spitalit përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

6. Ministria e Shëndetësisë kryen kompensimin financiar për shërbimin që kryen stafi akademik i Fakultetit të Mjekësisë në spital, bazuar në kontratat përkatëse.

7. Ministrisë së Shëndetësisë, në numrin e përgjithshëm të punonjësve, miratuar për vitin 2013, t’i shtohen 310 veta, numër i cili zbritet nga numri i përgjithshëm i punonjësve, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

8. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohen përkatësisht këto fonde:

- për paga, 249 000 000 (dyqind e dyzet e nëntë milionë) lekë;

- për sigurime shoqërore e shëndetësore, 41 500 000 (dyzet e një milionë e pesëqind mijë) lekë;

dhe

- në zërin “Mallra e shërbime”, 358 400 000 (treqind e pesëdhjetë e tetë milionë e katërqind mijë) lekë,

të cilat zbriten nga buxheti i parashikuar për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2013.

9. Të ardhurat dytësore të realizuara nga veprimtaria e spitalit dhe nga dhurimet, të përdoren totalisht nga vetë spitali, sipas udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë. Këto të ardhura të vlerësohen si të ardhura jashtë limitit.

10. Kontrolli fiziko-shëndetësor i personelit të Forcave të Armatosura dhe personeli ushtarak mjekësor i mbetur i Spitalit Universitar Qendror Ushtarak, me qëllim ruajtjen e aftësive profesionale, të vazhdojë të angazhohet në veprimtaritë e Spitalit Universitar të Traumës, bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

11. Të gjitha kontratat e lidhura nga Ministria e Mbrojtjes me palë të treta apo që kanë për objekt

ambiente të caktuara të saj të vazhdojnë të zbatohen nga Ministria e Shëndetësisë, konform dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

12. Prona me nr. 51 “Reparti ushtarak 7010 SUQU”, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshilli të Ministrave, të ndryshuar.

13. Vendimi nr. 357, datë 18.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e statusit “Spitali Universitar” Spitalit Ushtarak Qendror””, shfuqizohet.

14. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha